



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA SKRAPAR

RELACION

**“-PËR MIRATIMIN E DISA TRANSFERIMEVE NE BUXHETIN E VITIT 2024
MIRATUAR ME VKB NR. 44, DATE 15.12.2023“**

Të nderuar Këshilltar!

Grupi Menaxhimit Strategjik të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH”, neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me ligjin nr.57/2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9936, dt.26.06.2008”, i ndryshuar, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, propozon transferime të buxhetit të vitit 2024 të miratuar me VKB-nr. 44, date 15.12.2023 sipas tabelave të pasqyruara në projekt-vendim.

Ndryshimet konsistojnë në transferime buxheti nga diferenca e fondeve për investime të mbetura nga procedurat e prokurimeve në disa objekte investimesh.

Totali i kursimeve është në vlerën prej 1,479,262 leke të cilat do të akordohen në objektet:

- 1- Hartim Projekti për digën e rezervuarit Vendreshe në vlerën prej 1,200,000 leke.
- 2- Hartim Projekti për ndertimin e lërave në Njesin Administrative Potome në vlerën prej 120,000 leke.
- 3- Kolaudim punimesh në Objektivin: “Rehabilitimi urban në të dy anet e rrugës Arkitekt Kasemi”
- 4- Blerje kondicioneri për nevojat e nd.Sh.Publike në vlerën prej 94,762 leke.

Gjithashtu për arsye të zjarreve të rena në pyjet e territorit të Bashkisë Skrapar Punonjesit e MZSH janë angazhuar për fikjen e zjarreve për një periudhë kohe të gjatë duke punuar jashtë kohës normale të punës, kjo ka sjellë kosto shtesë për pagat dhe sigurimet shoqërore për mbulimin e të cilave kërkohet transferim nga shpenzimet operative në vlerën prej 800,000 leke dhe kalimin e këtij fondi në zërin paga në vlerën prej 686,000 leke dhe në zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore në vlerën prej 114,000 leke.

Ju faleminderit

